



Tiranë, më 27.02.2025

**Drejtuar:** Partia “Nisma Thurje”,  
Partia Lëvizja Bashkë”,  
Partia “Mundësia”,  
Partia Lëvizja e Legalitetit”,  
Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”,  
Partia Lëvizja “Atdheu”,  
Partia “Aleanca Kombëtare Shqiptare”,  
Partia “Koalicioni Euroatlantik”,  
dhe çdo partie, lëvizje apo individ;

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Ditët e fundit të muajit Shkurt po tregojnë gjithnjë e më qartë përpara shqiptarëve, se zgjedhjet parlamentare të 11 Majit 2025, nuk janë më zgjedhjet në të cilat do të diskutohet për programe elektorale. Janë zgjedhjet që do të vendosin nëse Shqipëria do të vijojë me të njëjtin intensitet luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe pandëshkueshmërisë, apo do të tuletet përpara presionit të politikës.

Këto janë zgjedhjet në të cilat partitë politike do të rreshtohen në luftë kundër SPAK dhe GJKKO apo në mbrojtje të tyre dhe të Reformës në Drejtësi.

Nisur nga ky kontekst i fushatës elektorale dhe i bashkimit të të gjithë faktorëve politikë që kanë për qëllim ta shkrijnë ose ta vendosin në shinat e kushtetueshmërisë SPAK dhe GJKKO, në koalicionet rreth PD dhe PS, lind si detyrë politike dhe qytetare që të gjitha partitë politike, lëvizjet qytetare dhe individët e angazhuar, ose që duan të angazhohen politikisht, të grupohen në një koalicion parazgjedhor.

Bashkimi në një koalicion parazgjedhor, nën moton e mbrojtjes së drejtësisë së re nga politika e vjetër, e vazhdimit të luftës kundër korrupsionit, e fundit të pandëshkueshmërisë dhe shembjes së një sistemi të vjetër politik, do krijonte premisat që në parlamentin e ri, ky grupim partish, lëvizjesh dhe individësh të sigurojë një numër të mjaftueshëm mandatesh për të garantuar që sistemi i drejtësisë të mbetet larg ndikimit dhe presionit të politikës.

Për këtë arsye propozojmë thirrjen e një tryeze të përbashkët, ndërmjet datave 28 Shkurt – 02 Mars për diskutimin në kolegjalitet të mundësisë për ndërtimin e koalicionit dhe modaliteteve të ndërtimit të tij.

Mbetemi në pritje të qëndrimit Tuaj.

Dashamir Shehi

